

KRIZA GLOBALE DHE REFLEKTIMI I SAJ NË EKONOMINË E KOSOVËS

*Dr. Ali Sylqa, prof. ord.
alisylqa@yahoo.com*

Abstrakt

Pasiguria e tanishme e ekonomisë ndërkombëtare përfaqëson një nga krizat më destruktive në shekullin e fundit, ndoshta me efekte aq shkatërruese sa asnjëherë më parë. Sistemi ekonomik i përgjithshëm ndërkombëtar, pothuajse të gjitha ekonomitë individuale kombëtare dhe ekonomitë në tranzicion të Evropës Juglindore janë ndikuar nga kjo krizë. Ekonomia e Kosovës, edhe pse e brishtë dhe jo e qëndrueshme sigurisht që do të ndikohet nga kriza globale. Shikuar nga prizmi metaforik, efekti do të jetë ai i valëve të detit, që d.m.th. pa marrë parasysh sa do të vonojë përplasja e saj me bregun, ajo gjithsesi se do të ndodh por intensiteti i saj do të jetë vështirë i parashikueshëm. Është e kuptueshme që nga rrethanat ekonomike të krijuara rishtas, posaçërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë të prekura nga trazirat aktuale të tregjeve ndërkombëtare. Përderisa argumentohet se kriza globale financiare nuk ka goditur Kosovën drejtpërdrejtë, ekonomia e saj ka ndjerë efektet e saj indirekte. Vendet donatore kanë hezituuar të rrisin ndihmën e tyre për Kosovën për shkak të problemeve të brendshme; rritja dramatike e papunësisë si në Evropë ashtu edhe në SHBA, ka prekur diasporën kosovare. Rënia pasuese e dërgesave nga kosovarët të cilët punojnë jashtë vendit ka mundësi të ketë ndikim negativ në ekonominë e Kosovës në përgjithësi.

Fjalët kyçe: Kriza globale ekonomike, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, konkurrenca, varfëria, remitanca.

JEL klasifikimi: O11, L26, M16

Hyrje

Nëse ka pasur ndonjë situatë kur duhej qenë në depresion për shkak të qëndrueshmërisë së euros, ajo ishte shënuar në vitin 2010, gjithsesi duke iu referuar krizës ekonomike botërore. Në tërë botën, lidhja në mes të globalizimit dhe integritit më të madh ekonomik, përveç përfitimeve, po ashtu ka shtuar edhe ekspozimin ndaj rrezikshmërisë, kështuqë si rezultat i kësaj dështimi ekonomik në një vend mund të prek shumë shpejt ekonomitë tjera kombëtare. Shembulli më i dalluar është ai që jemi duke përjetuar sot, pra kriza e cila i ka filltet e saj në sistemin bankar amerikan dhe shumë shpejt u shndërrua në recesionin më të thellë në historinë bashkëkohore të SHBA-ve dhe përfundoi në krizë globale ekonomike dhe financiare. Shkalla e papunësisë sot është më e larta në tridhjetë vitet e fundit, bursat kanë filluar të shënojnë rënie, ndërsa rënia e shpejtë e kërkesës së konsumatorëve ka bërë që ekonomia të fillojë të çalojë dhe ka kthyer mbrapshtë

trendet pozitive të rritjes ekonomike në shumë vende. Pako të ndryshme të ndihmave financiare në shumë prej miliarda euro janë futur në funksion nga shumë vende, si një masë emergjence për të parandaluar përhapjen e krizës në shumë ekonomi kombëtare.

1. Kriza globale vs ekonomia e Kosovës

BE-ja pas shumë debatesh miratoi një pako të jashtëzakonshme shpëtimi për Greqinë prej 110 miliardë eurosh. Nën presion të madh janë edhe vendet anëtare të Eurozonës dhe veçanërisht Irlanda dhe Portugalia. Aksionet në bursa në gjithë botën kanë shënuar rënie, ndërsa investitorët janë të shqetësuar për stabilitetin financiar të rajonit, që bën gati një të katërtën e ekonomisë botërore. Shumë evropianë druajnë se kanë parë vetëm një fragment të së ardhmes së tyre: një sëmundje ngjitëse që përhapet nga një vend pa borxhe te tjetri, trazira sociale për shkak të shkurtimit të numrit të vendeve të punës, vite të pavendosmërisë politike dhe dëbim ose tërheqje të vendeve nga Eurozona. Evropa po ballafaqohet me të gjitha format e problemeve sociale dhe politike, që mbase mund ose jo të manifestohen, por dilema kryesore qëndron te ekonomia. Nga perspektiva e tashme, as dhuna dhe as ankthi në tregjet financiare nuk janë dëshmi se plani i shpëtimit për Greqinë dhe strategjia më e gjerë evropiane në ballafaqimin me krizën e borxheve, kanë dështuar.

Trazirat, madje edhe ato të dhunshmet, janë pjesë e shpeshtë e jetës politike greke. Tregjet financiare nganjëherë reagojnë me shumë skepticizëm ndaj planeve shpëtuese ekonomike. Megjithatë, autori i shkrimit pohon se investitorët nuk janë të bindur në suksesin e pakos së ndihmës financiare, sepse fillimisht dyshojnë nëse premtimi prej 110 miliardë eurosh do të materializohet për shkak të vazhdimit të kundërshtimit politik në Gjermani ose nga frika se grekët do të heqin dorë nga kursimet e premtuara. Brenga tjetër e tyre ka të bëjë me Irlandën, Portugalinë dhe Spanjën, që ballafaqohen me stagnimin ekonomik dhe spiralen e borxheve. Tash është shumë e rëndësishme që Portugalia, Spanja dhe vendet tjera të dëshmojnë se ato nuk janë në pozitën e Greqisë.

Një hap tjetër do të ishte sigurimi i mekanizmit nga Bashkimi Evropian që t'i furnizojë me mjete të gatshme financiare ekonomitë më të dobëta të Eurozonës, nëse ato do të përfshihen nga paniku. Ankthi i Athinës nuk bën të përsëritet përgjatë kontinentit, por për ta evituar atë duhet guxim dhe ndershmëri më e madhe e liderëve evropianë.

Edhe pse deri më tani nuk ka ndonjë shenjë se Kosova është zhytur në ndonjë krizë financiare, ekspertët nuk e mënjanojnë mundësinë që kjo të ndodhë për arsye se shumica e vendeve evropiane janë përfshirë në krizën globale financiare. Kosova do të mund të ndikohej nga kriza botërore financiare vetëm nëpërmjet emigrantëve të cilët jetojnë në shtetet që janë të përfshira në këtë krizë.

Kosova është një vend mjaft i ri dhe natyrisht e ka një Bankë Qendrore që është shumë konservative në politikën e saj të mbikëqyrjes dhe natyrisht nuk e ka atë politikën monetare për shkak se vendi ynë e shfrytëzojmë valutën euro. Edhe pse deri më tani nuk ka ndonjë shenjë serioze se Kosova është zhytur në ndonjë

krizë financiare, ekspertët nuk e mënjanojnë mundësinë që kjo të ndodhë për arsye se shumica e vendeve evropiane janë përfshirë në krizën globale financiare.

2. Kushtet konkrete ekonomike të Kosovës

Në përgjithësi, ekonomitë e shteteve në tranzicion kanë qenë të mbrojtura nga ndikimi i tregjeve botërore përmes centralizimit të organizimit dhe shpërndarjes së prodhimit, si dhe nga dominimi i prodhuesve në tregun vendor. Për më tepër, tregjet e punës gjithashtu ishin fuqishëm të rregulluara ashtu që punëtorët gëzonin një shkallë të lartë të sigurisë dhe stabilitetit në punësim. Ndryshimet politike bënë të mundur reformat e vonuara ekonomike dhe sociale, të cilat hapen tregjet vendore për të importuar konkurrencën e jashtme gjersa në anën tjetër sfiduan destinimet tradicionale të eksportit. Kështu që, ndërmarrjet befasisht u ndeshën me një konkurrencë të rreptë që i shtyri ato të ristrukturojnë prodhimin dhe fuqinë punëtore brenda një kohe shumë të shkurtër.

Tani shoqëria kosovare si një shtet i pavarur do duhej të gjenerojë angazhime serioze institucionale për sistemin e pavarur ekonomik të Kosovës, të bazuar në ekonominë e hapur të tregut. Ajo duhet të krijojë mekanizmat nëpërmjet të cilëve bëhet rregullimi makroekonomik në kushtet e veprimit të tregut integral. Prona, pluralizmi i pronës, me dominim të pronës private, siguria e pronës dhe mbrojtja e saj është po ashtu një segment i rëndësishëm që sigurohet në këtë sistem. Tregu është rregullatori kryesor i aktivitetit ekonomik. Kosova, si një vend i vogël dhe ballkanik, duhet të orientohet për ndërtimin e sistemit të ekonomisë sipas kërkesave të një ekonomie të hapur ndaj tregut evropian dhe botëror, politikë të matur rregullative, sistem përkrahës fiskal, politika ekonomike-financiare favorizuese, si dhe liberalizim ekonomik. Andaj, preokupimet tona duhet të orientohen mbi të gjitha në: krijimin e kornizës ligjore dhe institucionale, zhvillimin e politikave integruese evropiane, hartimin e strategjive të njëmendta të zhvillimit ekonomik të vendit, privatizimin e plotë e të suksesshëm të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike.

2.1 Kriza dhe çmimet

Çmimet e konsumit në Kosovë janë ngritur për 7.8 për qind përgjatë periudhës shtator 2008 – shtator 2009. Kjo situatë shpjegohet për shkak të rritjes së çmimeve në tregun botëror. Ekspertët për çështje ekonomike japin mendime të ndryshme rreth ndikimit të krizës financiare në ngritjen e çmimeve të produkteve ushqimore në tregun kosovar. Kriza financiare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në disa vende të Bashkimit Evropian ka ndikuar në ngritjen e çmimeve edhe në tregun kosovar, pasi komuniteti i biznesit kosovar kryesisht varet nga kreditë e bankave komerciale.

Tani, për momentin, po shohim se ardhja deri te kreditë nga bankat komerciale është vështirësuar, për shkak të një kontrolli më të rreptë nga bankat me rastin e dhënies së kredive. Ngritja e çmimeve të huave ndikon po ashtu edhe në afarizmin e subjekteve ekonomike, që shprehet në çmimin në treg. Ngritja e

çmimeve në tregun kosovar nuk është pasojë e drejtpërdrejtë e krizës financiare, pasi Kosova ende nuk ka qasje në tregjet financiare ndërkombëtare. Ngritja e çmimeve më tepër ka të bëjë më ngritjen e inflacionit në Kosovë. Cikli i ngritjeve dhe i rënies në bursën ndërkombëtare është aq i shpejtë e në mënyrë pragmatike lë pasojë edhe në Kosovë. Kosova nuk ka qasje në tregjet financiare ndërkombëtare dhe Kosova është në atë periferinë e ndryshimeve edhe të ngjarjeve të përditshme që ndodhin.

Shkak tjetër për ngritjen e çmimeve në Kosovë është edhe importi i lartë, pasi që shumica e prodhimeve në tregun kosovar importohen nga vende të ndryshme të Evropës. Me moszhvillimin dhe prodhimin e produkteve vendore, Kosova është shumë e pafuqishme që të ndikojë në këto lëvizje të çmimeve në bursat botërore. Sikur Kosova të kishte një ekonomi më të zhvilluar dhe të kishte një prodhimtari më të zhvilluar, normalisht se në disa produkte Kosova nuk do të ishte e varur aq shumë nga importi.

2.3 Efekti i remitancës / dërgesat nga jashtë

Rëniet e remitancave dhe kthimi i emigrantëve në shkallë të madhe mund të shtojë presionin i cili, edhe në kontekst të rënies së rëndë ekonomike, nuk është ndjerë, bile as në masën më të vogël në rajon në tërësi. Në praktikë, trendi i remitancave mund të marrë pak kohë për t'u bërë i qartë. Ndërkohë që ka gjasa për presionet në rënie, ka edhe dëshmi se në tërë botën, remitancat kanë tendencë që të jenë elastike dhe të bien më butë sesa që pritet te rënia ekonomike. Kjo është pjesërisht sepse shumë që dërgohen në shtëpi janë shpesh të vogla (zakonisht rreth 5 për qind e të ardhurave) ashtu që pagesat shpeshherë mund të sigurohen edhe kur bien të ardhurat. Më tej, rrjedhat e remitancave dominohen nga pagesat nga emigrantët që kanë emigruar prej shumë kohësh të cilët, për shkak se shpeshherë janë përshtatur mirë në vendin e tyre të migrimit, mund të jenë në pozitë më të mirë për të gjetur burime alternative të të ardhurave në qoftë se humbin punën e tyre.

Rritja e normës së papunësisë në vendet e Evropës perëndimore ka goditur edhe emigrantët Kosovarë, duke zvogëluar kështu nivelin e dërgesave të emigrantëve drejt Kosovës, të cilat paraqesin një ndër burimet kryesore të financimit për ekonominë e vendit. Remitancat nga diaspora, kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra llogaritet të jenë rreth 30% e bruto produktit kombëtar (GDP). Po ashtu, rënia e kërkesës në sektorin e jashtëm, si rezultat i recesionit, është reflektuar negativisht edhe në nivelin e eksporteve, duke goditur industrinë kryesore eksportuese. Nën këto rrethana, shtrëngimi i kredithënies drejt sektorit real të ekonomisë mund të kontribuojë në thellimin e mëtejshmë të ngadalësimit të aktivitetit ekonomik në vend. Andaj, vazhdimi i kreditimit edhe në këtë kohë, duke respektuar parimet e kreditimit të shëndoshë, paraqet një faktor shumë të rëndësishëm për të stimuluar aktivitetin ekonomik në vend dhe për të mënjnuar në një masë efektet negative nga kriza.

2.4 Papunësia

Kosova edhe sivjet do të përballet me një gjendje të rëndë sociale, si pasojë e rritjes së vazhdueshme të papunësisë. Premtimet për hapjen e vendeve të reja të punës, që janë dhënë gjatë gjithë fushatës parazgjedhore, tashmë kanë mbetur në letër dhe i takojnë së kaluarës. Qeveria nëpërmjet të Ministrisë të Punës dhe Mirëqenies Sociale pohon se në të ardhmen nuk pritet ndonjë përmirësim i gjendjes sociale në Kosovë e as që do të ketë vende të reja të punës. Çdo vit në Kosovë janë të aftë për punë më shumë se 40 mijë të rinj, 25 deri në 30 mijë të rinj gjejnë punë të ndryshme në ekonomi familjare, apo bëjnë zgjidhje. Ndërkaq, 8 mijë deri në 10 mijë të rinj mbesin pa punë në vit. Këto parametra janë me të vërtetë shqetësuese dhe një alarm i kuq që fatkeqësisht vazhdon të mos e ndërrojë ngjyrën tash e një dekadë.

Sipas të dhënave më të reja të zyrave shtetërore të statistikave nëpër rajon, Kosova prinë për nga papunësia në rajonin e Ballkanit Perëndimor me mbi 40% të papunësisë. Maqedonia vjen menjëherë pas me 33%. Bosnja e Hercegovina është e treta me 23,4 %. Shqipëria me kuotën prej 13,7% është në një pozitë më të mirë në krahasim me shtetet e rajonit. Kosova dhe Maqedonia kanë shkallën më të lartë të papunësisë në Evropë. Paga më e lartë mesatare është në Slloveni dhe ajo arrin në 935, 11 Euro, përderisa për Kosovë nuk ka vlerësim të saktë të pagës mesatare. Bruto produkti kombëtar më i larti është në Slloveni dhe ai arrin në 18,367 euro për kokë banori, në Kroaci 14, 222 Euro, Mal të Zi 4,908 Euro, Serbi 4,651 dhe në Maqedoni e Bosnjë ai sillet rreth 3,200 Euro. Qytetarët e Kosovës janë më të varfërit në Evropë me një mesatare prej rreth 1700 € të ardhura për kokë banori, që është 1/3 e nivelit të Shqipërisë.

3. Ndërtimi i një sektori privat të shëndoshë

Tranzicioni mund të shihet si një element në procesin e gjerë të globalizimit, ashtu që analiza peshohet në atë nëse kjo do të ndalohej përkohësisht ose përjetësisht nga rënia ekonomike. Ndikimi dhe implikimet e recesionit për ekonominë në tranzicion është divers për shtetet e Evropës. Kjo është pasojë e shtegut të caktuar të tranzicionit që ato zgjedhin, për shembull në lidhje me shpejtësinë e privatizimit, çiltërsinë ndaj investimeve të huaja direkte, dhe shkallën e integritetit me BE, si dhe ndikimi i rëndë në kushtet fillestare, natyrisht reformat e tregut para tranzicionit dhe ndihmat në resurse natyrore. Konvergjenca në mes të ekonomive të zhvilluara dhe në tranzicion me siguri se do të rifillojë, edhe pse performanca mund të jetë më heterogjene, për shembull në mes të anëtarëve të BE-së dhe ata jashtë BE-së.

Ndërtimi i një sektori të tillë privat të shëndoshë kërkon një bazë të fortë në mjediset globale dhe vendase, në infrastrukturën, në sundimin e ligjit, etj. Themelet për rritje në sektorin privat fillojnë me makro biznes global që funksionon mirë duke përfshirë një ekonomi globale dinamike që siguron tregjet si dhe rregullat e përshtatshme të tregut që mundësojnë qasjen konkurruese ndaj mundësive të tregut. Shkëmbimi i hapur i mallrave, kapitalit dhe informacionit – dhe transferimi i teknologjisë, ideve stimulon zhvillimin e sektorit privat. Kjo ndodh nëpërmjet shumë mekanizmave; tregjeve të hapura, investimeve të huaja të cilësisë së mirë,

përkrähje efektive drejt zhvillimit, si dhe transferimi efikas i teknologjive dhe njohurive. Ajo kërkoi ato reforma si p.sh. heqja e subvencioneve bujqësore dhe formave të tjera të mbrojtjes që në mënyrë kaq evidente pengojnë zhvillimin e sektorit privat të orientuar drejt eksportit në zonat rurale të vendeve në zhvillim.

Ekziston një marrëveshje e gjerë që tregjet e hapura kanë mbështetur rritjen ekonomike. Përparësitë, ndonëse të ruajtura mirë, e meritojnë të përsëriten. Një politikë e tregtisë së hapur nxit rritjen e prodhimit duke hapur sektorin privat ndaj konkurrencës. Tregtia e lirë i ndihmon vendet të alokojnë burimet e tyre drejt fushave të tyre më efektive me përparësi krahasuese. Importet më të lira rrisin standardin vendor të jetesës dhe lejojnë përdorimin e inputeve me kosto më të ulët ndërkohë që sektori privat prodhon për konsumatorët e vendit dhe të huaj. Një regjim i tillë siguron qasje ndaj tregut të hapur nëpërmjet tarifave më të ulëta dhe barierrave të tjera.

Elementet qendrore të një makro-mjedisi të fuqishëm për biznesin përfshijnë paqen dhe stabilitetin politik, qeverisjen e mirë me hartimin e politikave të qëlluara, transparencën, si dhe politikat makroekonomike të shëndosha. Për bizneset konflikti i brendshëm ose i jashtëm rrit koston dhe pasigurinë, duke penguar investimet e brendshme dhe ato të jashtme. Duke u thelluar, konflikti pengon edhe zhvillimin e sektorit privat sepse çon në një shkatërrim tragjik të kapitalit njerëzor, keq-alokimin e burimeve të mangëta publike, shkatërrimin e resurseve të llojeve të ndryshme, pushtimin e burimeve natyrore, eliminimin e qasjes ndaj tregut, etj.

Lidhur me infrastrukturën, këtu përfshihen rrugët, energjia, uji, telekomunikacioni, portet, arsimin, shëndetësinë, etj. Ndërtimi i këtyre shërbimeve bazë ka një përfitim të dyfishtë, përmirësimi i jetës së popullsisë dhe mundësia e rritjes së biznesit. Infrastruktura e dobët e rrugëve, hekurudhave, energjia elektrike, etj mund të shkaktojnë humbje të ndjeshme për vendet në zhvillim. Në anën tjetër, infrastruktura e mbajtur mirë përmirëson tregtinë duke shpejtuar transportin e mallrave dhe lëndëve të para, duke ruajtur prodhimin intensiv të energjisë dhe duke e bërë informacionin lehtësisht të kapshëm dhe komunikimin në kohën e duhur. Rruga e kombit, e titulluar kështu për arsyen se simbolizon një kryevepër të paparë deri më tani, do të shërbejë si një gjenerator i fuqishëm i zhvillimit ekonomik të vendit tonë dhe rajonit. Ky projekti kombëtar infrastrukturor do të kompletohet me finalizimin e autoudhës Merdarë – Morinë.

Investimet në arsim dhe shëndetësi përfshijnë sektorin privat dhe publik. Në kundërshtim me besimin konvencional shumë nga shërbimet arsimore dhe shëndetësore në vendet në zhvillim sigurohen nga iniciative private, përfshirë kooperativat dhe organizatat reciproke të sigurimeve shëndetësore. Ligjet formojnë një shtresë esenciale të themelit për një sektor të shëndetshëm privat. Pa një kuadër ligjor transparent dhe një sistem administrativ të drejtë gjyqësor, përpjekje të tjera për të nxitur zhvillimin e sektorit privat nuk mund të funksionojnë ashtu siç është planifikuar. Qeveritë duhet të përcaktojnë 'rregullat e lojës', një sistem që redukton kostot e transaksionit duke i bërë ato të parashikueshme dhe të zbatueshme. Sistemet ligjore kontradiktore dhe hutuese i bëjnë praktikën e biznesit të vështirë për t'u realizuar. Legjislacioni i dobët mbron firmat oligarkike dhe bizneset e

korruptuara kundrejt forcave konkurruese, e që shpesh bien në kurriz të NVM-me. Marrëdhëniet e këndshme midis biznesit dhe rregullatorit dëmtojnë zhvillimin e konkurrencës së hapur të tregut të lirë. Shtresat më të ulta të shoqërisë goditen më së fortë në këto raste.

Korrupsioni dhe konfuzioni mbi detyrimin për të zbatuar rregullat janë shpesh për tu fajësuar për çmimin e lartë të përputhshmërisë. Burokracia, pengesat, vendim-marrjet arbitrare dhe kërkesa të tjera të dëmshme dëmtojnë aktivitetin privat. Praktikrat e korrupsionit shkatërrojnë çmimet dhe tregjet, si dhe pengojnë konkurrencën e hapur dhe të ndershme.

3.1 Rimëkëmbja dhe perspektiva ekonomike

Cilësia e menaxhimit të krizës do të përcaktojë kohëzgjatjen dhe seriozitetin, si dhe perspektivat ekonomike pas krizës. Përderisa askush nuk mund të parashikojë me saktësi kohëzgjatjen, thellësinë dhe pasojat e krizës, studimi i cikleve të biznesit tregojnë se do të përfundojë dikur, dhe ekonomia do të fillojë të rritet. Të shpresojmë se vendet më të mëdha do t'i shmangen joshjeve të proteksionizmit dhe se qeverisja globale ekonomike do të forcohet. Sidoqoftë ka gjasa të vogla që ekonomia botërore të rritet në ritmin e vërejtur më herët gjatë kësaj dekade. Politikat makroekonomike në ekonomitë më të mëdha duhet të jenë më pak akomoduese, dhe sektori financiar më pak i ndikuar dhe më rezistues nga rreziku. Në horizont nuk ka burime të mëdha të fitimeve nga produktiviteti. Është gjithashtu e qartë se ekonomitë do të përballen me pengesa më të fuqishme fiskale të cilat do të kërkojnë përshtatje serioze në politikën e shpenzimeve publike. Kthimi në reformat ekonomike dhe institucionale, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, mund të jetë rasti më i mirë për të rritur potencialin e rritjes globale.

Konkluzion

Deri tani ka një konsensus se efektet e krizës globale ekonomike në Kosovë kanë qenë modeste në rastin më të mirë. Megjithatë, pasi që Kosova kërkon më tej integrimin ekonomik, ajo nuk mund të mbetet e mbrojtur prej tronditjeve në të ardhmen, prandaj do të duhet të zhvillojë një politikë largpamëse të menaxhimit fiskal. Çfarë del si një implikim i rëndësishëm për Kosovën është se politika fiskale, si instrument i vetëm kur ka edhe presione të mëdha për shpenzime që tendosin financat e qeverisë, mund të jetë e rrezikshme sidomos kur deficitet financiare në rritje bëhen më të vështira.

Për shumicën e ekonomive në tranzicion, procesi i tranzicionit, sikurse vet globalizimi, ka gjasa që të rifillojë pasi që të kalohet kjo krizë në ekonomitë e zhvilluara. Sidoqoftë përkohësisht, disa ekonomi në tranzicion ka gjasa që të vuajnë më shumë sesa ekonomitë e zhvilluara, që do të thotë se për disa vite procesi i konvergencës mund të shkojë mbrapsht. Këto vende ka gjasa që të jenë ato të Ballkanit dhe ish Bashkimit Sovjetik, natyrisht duke përfshirë këtu edhe Kosovën.

Referencat

1. Konferenca Ndërkombëtare “Ndikimi i krizës financiare në Ballkan dhe në Kosovë”, Prishtinë, 2009;
2. Megginson, “The financial Economics of Privatization”, 2005;
3. Raporti për vitin 2009 i Entit të Statistikave të Kosovës;
4. Revista kroate “Banka”, maj 2010;
5. Selmanaj Selman, “Globalizimi dhe Tranzicioni – dilemat dhe sfidat”, 2006;
6. Tatjana Soubotina, “Beyond Economic Growth”, 2000;
7. Transparency International, “Transparency International Corruption Perceptions Index”, Berlin 2003;
8. United Nations DESA, “World Economic Situation and Prospects”, 2009;
9. Zhvillimi dhe Tranzicioni, UNDP, 2009;
10. World Economic Forum, “Globalisation of Alternative Investments”, 2008;